

KONTAKT sh.p.k.

Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA:

	Faqe
Raporti i audituesit te pavarur	
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2019	1
Pasqyra e Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	3
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	4
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	5-29

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar Aksionerit dhe Drejtimit të KONTAKT sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare KONTAKT sh.p.k. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël (kodi IESBA) të publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët dhe kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe, ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pa kualifikuar mbi ato pasqyra në 21 mars 2019.

Informacione të tjera

Informacionet e tjera përfshijnë informacione që përfshihen në Raportin Vjetor të Shoqërisë, por nuk përfshihen në pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose, nëse duket se ato përmbajnë anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me palët e ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbulimin e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevantë për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe zbulimeve përkatëse të bëra nga Manaxhimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, të zbatuar nga Manaxhimi dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin e auditimit tek informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese të lidhura me pasqyrat financiare ose, nëse informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese është i pamjaftueshëm, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund t'i shkaktojnë Shoqërisë ndërprerjen e vazhdimësisë në përputhje me parimin e vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare vjetore, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, si dhe nëse pasqyrat financiare vjetore paraqesin transaksionet dhe ngjarjet kryesore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.


Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

BDO ALBANIA SHPK
BDO Albania sh.p.k.

12 mars 2020
Tiranë, Shqipëri

BDO
BDO ALBANIA sh.p.k.
NIPT L02407004C
TIRANA - ALBANIA

Besjana Doda
Partner Angazhimi



KONTAKT sh.p.k.

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në Lek)

AKTIVET	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktive afatgjata materiale	3	128,419,634	130,676,286
Aktive afatgjata materiale të investuara	3	141,386,261	148,531,587
Aktivitet afatgjata jomateriale	3	300,537	384,094
Totali i aktiveve afatgjata		270,106,432	279,591,967
Aktivitet afatshkurtra			
Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4	85,239,000	-
Llogari të arkëtueshme	4	37,893,824	20,415,185
Llogari të arkëtueshme të tjera	4	71,648,431	70,590,600
		194,781,255	91,005,785
Inventari	5	1,388,130,438	1,137,234,168
Parapagesat për furnizime	5	17,041,920	37,245,173
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	5	1,222,972,968	1,420,549,313
		2,628,145,326	2,595,028,654
Mjete monetare	6	48,951,953	14,900,947
		48,951,953	14,900,947
Aktivitet totale afatshkurtra		2,871,878,534	2,700,935,386
TOTALI I AKTIVEVE		3,141,984,966	2,980,527,353
PASIVET DHE KAPITALI			
Kapitali aksioner	7	659,221,542	659,221,542
Rezerva ligjore	7	1,253,178	1,253,178
Fitimi i pashpërndarë	7	227,354,014	159,174,214
		887,828,734	819,648,934
Pasivet Afatgjata			
Huamarrje afatgjata	8	519,628,924	441,742,906
Grande dhe të ardhura të shtyra	8	505,589	19,664,635
Totali i pasiveve afatgjata		520,134,513	461,407,541
Pasivet Afatshkurtra			
Huamarrje - afatshkurtër	8	50,220,262	29,111,632
Të pagueshme ndaj furnitoreve	9	139,730,600	47,829,813
Të pagueshme ndaj punonjesve	9	749,710	11,122,973
Detyrime tatimore	9	5,706,918	2,017,515
Të tjera detyrime	9	348,136,484	438,450,365
Paradhenie/ parapagime të arketuara	9	1,189,477,745	1,170,938,580
Totali i pasiveve afatshkurter		1,734,021,719	1,699,470,878
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		3,141,984,966	2,980,527,353

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare (faqet 5 deri 29).

KONTAKT sh.p.k.**Pasqyra e fitimit dhe të ardhurave gjithë përfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Të gjitha shumat në Lek)*

		Për vitin e mbyllur Shënime më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shitjet neto	10	1,267,012,463	964,555,098
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	10	18,788,634	7,408,125
Ndryshim ne punet ne proces	10	1,017,550,558	180,468,647
Ndryshim ne inventarin e produktit te gatshem	10	(968,077,382)	(240,488,365)
Mallrat, lendet e para dhe sherbimet	11	(295,789,291)	(144,276,796)
Punime ndertimi		(367,178,341)	(323,291,973)
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	12	(548,685,408)	(119,028,015)
Shpenzime te personelit	13	(158,134,930)	(97,911,958)
Renia ne vlere (zhvleresimi) dhe amortizimi	3	(34,991,146)	(36,486,150)
Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		(69,504,843)	190,948,613
Te ardhurat dhe shpenzimet financiare	14	164,407,330	(3,506,113)
Fitimi (humbja) para tatimit		94,902,487	187,442,500
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	15	(26,722,687)	(28,268,286)
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		68,179,800	159,174,214

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare (faqet 5 deri 29).

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga drejtimi i shoqërisë KONTAKT sh.p.k. në 27 shkurt 2019 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Fatmir Bektashi
Administrator i përgjithshëm



Suzana Aliaj
Drejtore financiare

KONTAKT sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në Lek)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore statutore	Fitimi i pashperndare	Totali
Pozicioni me 31 dhjetor 2017	394,714,953	1,253,178	264,506,589	660,474,720
Fitimi neto per periudhen kontabel 2018	-	-	159,174,214	159,174,214
Dividendet e paguar	-	-	-	-
Rritje e rezerves se kapitalit	-	-	-	-
Rritje e kapitalit	264,506,589	-	(264,506,589)	-
Pozicioni me 31 dhjetor 2018	659,221,542	1,253,178	159,174,214	819,648,934
Fitimi neto per periudhen kontabel 2019	-	-	68,179,800	68,179,800
Dividendet e paguar	-	-	-	-
Rritje e rezerves se kapitalit	-	-	-	-
Rritje e kapitalit	-	-	-	-
Pozicioni me 31 dhjetor 2019	659,221,542	1,253,178	227,354,014	887,828,734

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare (faqet 5 deri 29).

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrytezimit		
Fitimi para tatimit	94,902,487	187,442,500
Rregullime per:		
Amortizimin	34,991,146	32,069,191
Humbje/Fitime nga shitja e AAGJ	(530,949)	-
Te Ardhura nga Investime	(4,683)	-
Shpenzime te maturuara	4,300	-
Humbje/Fitim nga rivleresimi	8,456	-
Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera	(103,775,470)	38,839,922
Rritie/renie ne tepricen inventarit	(33,116,672)	(917,934,241)
Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve, per t'u paguar	34,550,840	297,183,580
Parate e perftuara nga aktivitetet	<u>27,029,455</u>	<u>(362,399,048)</u>
Interes i paguar	-	-
Tatimfitimi i paguar	(26,633,154)	(28,268,286)
Fluksi i parave nga veprimtarita operative	<u>396,301</u>	<u>(390,667,334)</u>
Blerja e aktiveve afatgiata materiale	(29,676,024)	(50,296,917)
Te ardhura nga shitja e paiisjeve	4,603,754	11,341,873
Interesi i arketuar	-	-
Paraja neto, e perdorur ne aktivitetet investuese	<u>(25,072,270)</u>	<u>(38,955,044)</u>
Fluksi i parave nga veprimtarite financiare	58,726,975	441,574,908
Paraja neto e verdorur ne aktivitetet financiare	<u>58,726,975</u>	<u>441,574,908</u>
Rritja/renia neto e mjeteve monetare	<u>34,051,006</u>	<u>11,952,530</u>
Mjetet monetare ne tillim te periudhes kontabel	<u>14,900,947</u>	<u>2,948,417</u>
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	<u>48,951,953</u>	<u>14,900,947</u>

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare (faqet 5 deri 29).

1. Te përgjithshme

Shoqëria "KONTAKT." shpk është themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me vendim të ortakeve të datës 21/12/2000 dhe është regjistruar në Qendren Kombëtare të regjistrimit më dt 07/06/1999

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe nga statuti dhe legjislati shqiptar në fuqi.

Shoqëria ka si objekt: Ndërtim ambjente banimi dhe shërbimi, punë publike e ndërtime civile, sinjalistike rrugore, tregëti, import eksport etj.

Në vitin 2019 janë kryer punime ndërtimi në disa projekte, për komplekse banimi e shërbimesh, import materiale, tregëtim materiale ndërtimi etj. Aktiviteti është kryer në territorin Shqiptar.

Kapitali i shoqërisë zotërohet 100% nga ortakët i vetëm, Z. Fatmir Bektashi.

Aktiviteti tërëzuar të saj përbëhen nga ndërtesa, makineri e pajisje, mjete transporti, pajisje zyre dhe informatike. Kapitali i shoqërisë paraqitet në shumën 659,221,542 lekë, kapital i regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëria drejtohet nga Administratori, Z. Fatmir Bektashi, që është dhe ortak i vetëm në shoqëri. Atij i perkasin të gjithë kompetencat për drejtimin ekzekutiv të përgjithshëm.

2. Politikat kryesore kontabel

2.1. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të publikuara nga Bordi i Standarteve Nderkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Përgatitja e pasqyrave Financiare në përputhje me kërkesat e SNRF, kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabel të rendesishme. Kjo gjithashtu kërkon që drejtimi i Shoqërisë të japë gjykimin e tij mbi zbatimin e politikave kontabel të tyre. Fushat, të cilat kërkojnë një shkallë të lartë ose komplekse të gjykimit, ose ato për të cilat vlerësimet apo supozimet janë të rendesishme për hartimin e pasqyrave financiare paraqiten në shënime.

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabel si dhe të ardhurat perkatëse.

Shpenzimet e kryera gjatë një periudhë raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njesise ekonomike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili përfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, bëhet në mënyrë të kompjuterizuar, me anë të programit financiar Finance 5.

Deklarimet financiare janë shprehur në Lekë, e cila është monedha shqiptare.

Drejtimi i shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe vlerëson që shoqëria ka burime dhe perspektiva për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjell dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj Pasqyrat Financiare vazhdojnë të përgatiten në baze të parimit të vijimësisë.

2.2. Periudha krahasuese

Për prezantimin konsistent të transaksioneve, klasifikimi i zerave të caktuar në informacionin financiar krahasues, është ndryshuar për të qenë në përputhje me trajtimin e vitit aktual. Riklasifikimet janë bërë si më poshtë:

- Klientët të paarkëtuar janë riklasifikuar nga aktive të tjera në të drejta të arketueshme.
- Huatë janë riklasifikuar në hua nga palet e lidhura, të treta dhe institucione financiare. Gjithashtu kështu e huatë bankare janë klasifikuar si hua afatshkurtra për të dy periudhat.

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.2. Periudha krahasuese (vazhdim)

- Autofaturimet janë netuar në llogarite perkatese të shpenzimit
- Kosto e objekteve gjate procesit të ndertimit është zbritur nga zeri llogari të arketueshme dhe është vendosur në zerin Inventar, Prodhim në Proces dhe Produkt i gatshëm perpatesisht objete në ndertim dhe objete të perfunduara të hipotekuara dhe ende të pa shitura.

2.3. Gjykime të rëndesishme kontabel, çmuarjet dhe vleresimet

Pergatitja e Pasqyrave Financiare në perputhje me SNRF kërkon gjykime dhe vlersime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabel dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlersuara nga shoqëria.

Vlersimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëposhtme dhe faktore të tjera, përfshirë dhe pritshmerite për ngjarjet e ardhshme, të cilat besohet se janë të pershtatshme dhe të rëndesishme për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga keto vlersime.

Informacioni mbi elemente të rëndesishme në vlersimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabel që kanë efekt me të rëndesishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura me poshte:

2.3.1. Përcaktimi i vlerës së drejte

Shoqëria nuk ka politika të rëndesishme kontabel dhe dhenie informacionesh shpjeguese të miratuara nga vet shoqëria, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejte, si për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jofinanciare. Vlerat e drejta është përcaktuar për qëllime të matjes dhe prezantimit. Aty ku është e aplikueshme, informacionet në lidhje me supozimet e bera në përcaktimin e vlerave të drejta janë shpalosur në shënime specifike për ato aktivet ose detyrimet.

Drejtimi i shoqërisë vleron vlerë të drejte të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të mjeteve monetare, llogarive të arketueshme, llogarive të pagueshme, aktiveve të tjera afatshkurtra të këtyre instrumentave.

2.4. Instrumentat financiarë

Shoqëria ka vetëm instrumenta financiare jo-derivative, përfshirë dhe kërkesa nga kliente dhe kërkesa të tjera, mjete monetare dhe ekuivalente me to, huamarrje dhe huadhenie, furnitore dhe të tjera detyrime.

Instrumentat financiarë jo-derivative njihen, fillimisht, me vlerën e drejte plus, çdo kosto të drejtperdrejte transaksioni të lidhura me to, përveç atyre të përshkruara me poshte. Në vazhdim të njohjes fillestare instrumentat financiarë vlerësohen si me poshte.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria është pale në kushtet e kontratës. Aktivet financiare nuk njihen nëse të drejtat e Shoqërisë mbi rrejdhat e ardhshme të parase të gjeneruara nga aktiviteti financiar kanë mbaruar ose nëse shoqëria i transferon aktive financiare një pale të tretë pa mbajtje të drejtat e kontrollit ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga aktiviteti. Blerja dhe shitja normale e aktiveve financiare kontabilizohet në datën e shitblerjes psh. datën në të cilën shoqëria vendos vete të blejë apo të shesë aktivet. Detyrimet financiare nuk njihen me nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuar në kontratë mbarojnë afatin, shlyen ose anulohen.

Një detyrim financiar cregjistrohet kur detyrimi shlyhet, mbyllet ose perfundon afati i tij. Kur një detyrim financiar ekzistues zevendesohet me kushte të ndryshme nga një tjetër detyrim i të njëjtit kontraktor ose kushtet e detyrimit ekzistues modifikohen ndjeshëm, atëherë ai do të trajtohet si cregjistrim i detyrimit aktual dhe njohjes se një detyrimi të ri. Diferenca nga kryerja e transaksionit do të njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Detyrimet dhe të drejtat financiare netohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejte ligjore për të netuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë keto neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.4 Instrumentat financiare(vazhdim)

2.4.1. Mjetet Monetare

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

2.4.2. Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar afatshkurtera jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar, pra me vleren e koston se tyre minus provizionet e krijuara per renie ne vlere. Provizione te lejuara mund te llogariten, per shumat e vleresuara si te rikuperueshme, ne fitim humbje kur ekziston nje evidence objektive qe keto kerkesa jane zhvleresuar me pare. Shoqeria aktualisht nuk llogarit dhe kontabilizon provizione.

2.4.3. Detyrime te pagueshme

Detyrimet per t'u paguar dhe te tjera detyrime paraqiten me vleren e drejte te tyre dhe me pas maten me vleren e tyre te amortizueshme.

2.4.4. Huate bankare dhe te tjera

Ne vazhdim te njohjes fillestare, huate bankare dhe te tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur çdo diference midis koston dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv. Norma efektive e interesit eshte norma e cila shkakton ekzaktesisht pagesat e ardhshme te vleresuara pergjate jetes se pritshme te detyrimit financiar ose, ku eshte e pershtatshme, per nje periudhe me te shkurter.

Kontabilizimi i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare sqarohet ne piken 2.16.

Aktivete financiare klasifikohen si detyrime afatshkurtra pervec rasteve kur shoqeria ka te drejte te pakushtezuar te ndryshoje marreveshjen e huase per te pakten 12 muaj pas dates se bilancit.

2.5. Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre Shoqeria vlereson inventarin me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvleresimit ne daten e mbylljes se bilancit. Shuma e zhvleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ka faktore objektive qe tregojne qe inventaret jane zhvleresuar. Per kete periudhe nuk ka rivleresime.

2.6. Inventar prona

Prone e blere ose qe po ndertohet per shitje ne rrjedhen normale te biznesit, ne vend qe te mbahet per t'u dhene me qera ose fitimi nga rritja e vleresimit te kapitalit, mbahet si inventar dhe matet me vleren me te vogel mes koston historike dhe vleres neto te realizueshme (VNR).

Kostoja perfshin:

- Te drejtat mbi pasurin e lire dhe qiran mbi token
- Shuma e paguar per kontraktuesit per ndertim
- Kostot e huamarrjes, koston e planifikimit dhe te projektimit, koston e infrastruktures, tarifat profesionale per sherbimet ligjore, taksat e transferimit te prones, shpenzimet e ndertimit dhe shpenzimet e tjera te ngjashme.

Komisionet e pakthyeshme qe u paguhen shitesve ose agjenteve te marketingut per shitjen e njesive te pasurive te paluajtshme shpenzohen kur paguhen.

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.6. Inventar prona (vazhdim)

VNR është cmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhjen normale të biznesit, bazuar në cmimet e tregut në datën e raportimit minus kostot e vlerësuara të perfundimit dhe kostot e vlerësuara të nevojshme për të bërë shitjen, duke marrë parasysh vlerën e parase në kohë nëse është materiale

Kostoja e pronës së inventarit e njohur në fitim ose humbje përcaktohet duke iu referuar shpenzimeve specifike të shkaktuara në pronën e shitur dhe alokimin e çdo kostoje jo specifike bazuar në madhësinë e pronës së shitur.

2.7. Aktivet Afatgjata të Investimit

Aktivët Afatgjata të Investimit, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qirata dhe/ose për rivlersimin e kapitalit (duke përfshirë edhe prona për qëllime të tilla), vlerësohen fillimisht me kosto duke përfshirë edhe kostot e transaksionit. Ato fillimisht njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe perfitimet nga pronësia transferohet të shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar ose jo.

Pas njohjes fillestare, aktivët afatgjata të investimit maten me vlerën e drejtë, e cila reflekton kushtet e tregut në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerat e drejta të pronave të investimit përfshihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato paraqiten, duke përfshirë efektin përkatës tatimor.

Transaksionet behen (ose nga) aktivët afatgjata të investimit vetëm kur ka një ndryshim në përdorim. Për një transferim nga aktivët afatgjata në inventar, kostoja e supozuar për kontabilitetin pasues është vlera e drejtë e ndryshimit në përdorim.

2.8. Aktivet Afatgjata Materiale

Në bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. (Aktualisht nuk ka humbje të akumuluar).

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtperdrejtë me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshijnë koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtperdrejtë me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e caktuar, kostot e cmontimit dhe levizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zera të transferuar nga të ardhurat përmbledhëse të tjera në lidhje të fitimeve apo humbjeve të flukseve të parase të kualifikuara nga mbulimi për blerjen e pronave dhe pajisjeve. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përberëse të funksionalitetit të pajisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisjeje.

Në momentin që një nga aktivët afatgjata materiale, përbehet nga pjesë me jetegjatesi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve materiale përcaktohen duke krahasuar arketimet nga shitja me vlerën kontabel neto të aktivitetit dhe njihet neto në të ardhura ose humbje të tjera.

2.8.1. Kostot në vijim

Kostot për zhvlerësimin e një aktivi regjistrohen me vlerën kontabel të aktivitetit në rast se është e mundur që perfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të, të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri.

Vlera kontabel e pjesëve të ndërtuara si rrjedhojë c' regjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtësive dhe pajisjeve regjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.8.2. Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e mbetur të aktivitetit në fund të çdo viti, e cila është kosto historike minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhese të performancës bazuar në metodën e vlerës së mbetur sipas normave për secilin kategori asetesh:

A. Ndertesa	5%
B. Makineri pajisje	20%
C. Mjete transporti	20%
D. Pajisje informatike	25%
E. Pajisje zyre	20%

Toka, Nderimet në Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.

2.9. Aktivet Afatgjata Jo-Materiale

Për vitin 2019 shoqëria zoteron Aktive Afatgjata Jo-Materiale. Vlera e saj e mbetur i përket Certifikatës ISO dhe programeve kopmjeterike si Financa 5 dhe Aplikacion në web për menaxhimin e klienteve.

2.10. Kuotat e kapitalit

Kuotat e thjeshta njihen si kapital. Kuota njihet me vlerën nominale 100 leke secila.

2.11. Rishikimi i zhvlersimit

Rikuperimi i aktiveve është një ceshtje që kërkon gjykim të Drejtimit, që kërkon vlersim nëse vlera kontabel e aktiveve mund të mbetet në vlerën neto aktuale të flukseve monetare të ardhshme që pritet të gjenerohen nga përdorimi i aktiveve të tilla duke përdorur parashikimet e flukseve monetare të cilat janë skontuar me një normë të pershtatshme. Në llogaritjen e vlerës aktuale neto të flukseve monetare të ardhshme, janë të nevojshme supozime në lidhje me ceshtjet e pasigurta, siç përmendet më poshtë.

Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar kërkojnë që Drejtimi të kryejë teste vjetore për zhvillimin e aktiveve dhe përcaktimin e jetës së tyre, gjithashtu kërkohet dhe vlerësimi i situatave të mundshme që do të sillnin mosrikuperimin e vlerës së aktiveve. Bazuar në informacionin e disponueshëm dhe testimet, shoqëria ka arritur në përfundimin se nuk ka indikacione për zhvlersim të aktiveve më 31 Dhjetor 2019.

2.11.1. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlerat kontabel të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventareve dhe tatimeve të shtyra, rishikohen në çdo datë raportimi për të parë nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabel e një aktiviteti është më e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

2.11.2. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse ekzistojnë tregues sipas të cileve një ose disa ngjarje kanë pasur një ndikim negativ në vlerësimin e fluksëve të ardhshme të parase prej atij aktiviteti. Humbja nga zhvlerësimi në rastin e një aktiviteti financiar të vlerësuar me kosto të amortizuara llogaritet si diferencë midis vlerës kontabel (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme të parase të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të një rendësie të vecante testohen për zhvlerësim në mënyrë të vecante. Pjesa tjetër e aktiveve vlerësohet së bashku, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Interesi nga aktiviteti i zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nepermjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje shkakton zvogëlimin e renes së vlerës, shumat përkatëse rimerret nepermjet pasqyrës përmbledhese të të ardhurave.

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.11.2. Zhvleresimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Humbja nga zhvleresimi mund të anulohet nëse ajo mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së zhvleresimit. Për aktivet financiare të vlersuara në kosto të amortizuara anulimi i zhvleresimit njihet në fitim humbje.

2.11.3. Marreveshjet e perbashketa

Marreveshjet e perbashketa kur kemi do të inkorporohen vecmas. Shoqëria, pasi të marrë parasysh strukturën dhe formën në marreveshjen, kushtet e dokumentuara nga palet në marreveshjen kontraktuale dhe të drejtat e shoqërisë dhe detyrimet që rrjedhin nga marreveshja, do të klasifikojë interesat e saj si aktivitet financiar sipas SNK 39.

2.12. Perfitimet e punonjesve

2.12.1. Kontributet e sigurimeve shoqërore

Gjate ecurisë normale të biznesit, shoqëria ben pagesa në emer të saj dhe të punonjesve për kontributet e sigurimeve shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Keto kosto në emer të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhese të të ardhurave e shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

2.12.2. Pensioni i detyrueshem

Shoqëria, gjate aktivitetit të saj, ben pagesa në emer të saj dhe në emer të punonjesve për të kontribuar në planin e pensionit sipas legjislacionit. Keto kosto i takojnë shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.

2.12.3. Leja e zakonshme

Shoqëria njeh si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhura ose lejen vjetore e cila pritet të paguhet me shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësit për periudhën.

2.13. Provigjonet

Një provigjon njihet kur, si pasoje e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vertetësi, dhe ka mundësi që të ketë dalje të flukseve të ardhshme të parase për të shlyer këto detyrime. Provigjonet përcaktohen si aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë takse që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parase dhe rrezikun specifik të detyrimeve. Drejtimi e ka të qartë këto proces, por nuk ka marrë vendime për provigjionim të ndonjë dukurie të pritshme, pasi gjykon që nuk riskon. Bazuar në kushtet e kontratës dhe në eksperiencën e viteve të kaluara nuk do të kemi kërkesa për garnaci punimesh nga klientet.

2.14. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë rritje të perfitimeve të njesisë ekonomike gjate një periudhe kontabel të cilat mund të shfaqen në formën e hyrjes së mjeteve monetare, rritjes së aktiveve ose uljes së detyrimeve, të cilat do të çojnë në rritje të kapitalit. Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejte të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjate aktivitetit të zakonshëm të Shoqërisë.

Të ardhurat përfshijnë shumat neto pa përfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, të cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat janë njohur kur ndryshimi i pronësive së bashku me riskun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi.

Kriteret specifike të njohjes të përfshira me poshte duhet të plotësohen para se të njihen të ardhurat.

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.14. Njohja e te ardhurave (vazhdim)

2.14.1. Shitja e pronës së perfunduar

Nje pasuri konsiderohet si e shitur kur shoqëria permbysht detyrimet e performances qe lidhen me shitjen e pronës, bazuar ne kontraten e shitblerjes. Nepermjet kesaj kontrate shoqëria i kalon bleresit te gjitha risqet dhe perfitimet qe mund te vijne nga perdorimi i pronës objekt kontrate. Per kontratat me shkembime te kushtezuara, shitja njihet vetem kur plotesohen te gjitha kushtet e rendesishme. Detyrimet e performances per shitjen e pronës së perfunduar plotesohen ne nje moment ne kohe.

2.14.2. Shitjet e pronës ne zhvillim

Aty ku prona eshte ne zhvillim e siper dhe eshte arritur marreveshje per te shitur nje prone te tille kur ndertimi eshte i plote, shoqëria shqyrton nese kontrata perfshin:

- Nje kontrate per ndertimin e nje prone, ose
- Nje kontrate per shitjen e nje prone te perfunduar

Kur nje kontrate percaktohet te jete per ndertimin e nje prone, te ardhurat njihen pergjate kohes ne perputhje me kerkesat e SNRF 15 duke perdorur metoden e perqindjes se perfundimit sipas progresit te ndertimit, bazuar ne situacionin mujor te punimeve.

Kur kontrata percaktohet te jete per shitjen e nje prone te perfunduar, te ardhurat njihen kur shoqëria permbysht detyrimet e performances qe lidhen me shitjen e pronës.

Duke ju referuar kriterëve te percaktuara ne paragrafet 35 dhe pikat a, b,c ; paragrafit 38 te SNRF 15 si dhe kushteve te specifikuara ne kontraten e siper marrjes kompania vlereson se nuk e ploteson kriterin e njohjes se te ardhurave pergjate kohes dhe per kete arsye do te zbatoje njohjen e te ardhurave ne nje moment kohe. Ky moment do te jete transferimi i pronës ne momentin e hartimit te kontrates se shitblerjes, i cili eshte edhe akti final per transferimin e risqeve dhe te pergjegjesive tek bleresi.

2.14.3. Te ardhurat nga qiraja

Te ardhurat nga qiraja jane te perfitime ekonomike qe i linden shoqërise nga qirate operative, duke perjashtuar te ardhurat nga qirate e kushtezuara, te cilat njihen kur ato plotesohen. Kostot fillestare direkte qe ndikojne ne rritjen e vleres se aktiviti dhe qe ndodhin ne momentin e negociimit te nje kontrate qiraje operative, njihen si shpenzim gjate kohezgjatjes se qirase, ne te njejten menyre si te ardhurat nga qiraja, aktualisht shoqëria nuk ka patur te tilla.

Kushtet lehtesuese te nje marreveshje qiraje jane te percaktuara ne termat e qirase dhe shperndahen gjate afatit te qirase, edhe nese pagesat jane kryer mbi kete baze. Termat e qirase jane te pakthyeshme gjate kohezgjatjes se qirase se bashku me cdo term tjeter, deri ne momentin kur qiramarresi ka opsionin e te ardhurave kur lind e drejta e perfitimit te tyre.

2.14.4. Pagesat e sherbimit, pagesat e menaxhimit dhe shpenzimet e tjera te rikuperueshme nga qiramarresit

Te ardhurat qe rrjedhin nga shpenzimet e rialokuara per qiramarresit njihen ne periudhen ne te cilen kompesimi behet i arketueshem. Tarifat e sherbimit dhe te menaxhimit dhe faturat e tjera te tilla perfshihen ne te ardhurat neto nga qiraja bruto nga kostot perkatese.

2.14.5. Te ardhurat nga interesi

Te ardhurat nga interesi njihen sic ato realizohen duke perdorur metoden e interesit efektiv (EIR). Interesi efektiv eshte norma qe saktësisht zbrit flukset e ardhshme te vleresuara gjate jetes se prishme te instrumentit financiar ose nje periudhe me te shkurter, kur eshte e pershtatshme ne vleren kontabel neto te aktivitetit financiar. Te ardhurat nga interesi jane te perfshira ne te ardhurat financiare ne pasqyren e fitimit ose humbjes.

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.15. Qiraja

Qirate klasifikohen si qira financiare kur kushtet e qirase transferojne ne menyre domethenese te gjitha risqet dhe perfitimet e pronesise tek qiramarresit. Te gjitha qirate e tjera klasifikohen ne qira operative. Pagesat e bera per qirane jane paraqitur ne pasqyren e performances ne baze lineare pergjate kohezgjatjes se kontrates. Shoqeria ka hyre ne marreveshje qiraje per prone tregtare, dhe ka percaktuar, bazuar ne vleresimet kushtet e marreveshjes, se nuk zoteron te gjitha risqet dhe perfitimet mbi keto prona dhe per kete arsye i konsideron ato si qira operative

2.15.1. Shoqeria si qiramarrese

Qirate financiare qe transferojne rrezikun dhe perfitimet ne menyre aksidentale tek shoqeria, jane kapitalizuar si nje fillim i ri i qirase me vleren e drejte te prones se dhene me qira, ose ne qofte se eshte me e vogel me vleren aktuale te minimumit te pagesave te qirase. Pagesat e qirase jane te ndara midis pagesave financiare dhe uljes se detyrimit ndaj qirase, per te arritur ne nje nivel konstant te interesit ne tepricen e mbetur te detyrimit. Pagesat financiare jane njohur si kosto financiare ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Nje aktiv i dhene me qira eshte amortizuar gjate jetes se dobishme te tij. Megjithate, me qene se shoqeria nuk ka nje siguri qe do ta zoteroje pronesine ne fund te kohezgjatjes se qirase, aktivi do te amortizohet per nje periudhe me te vogel se jeta e dobishme e tij.

2.15.2. Shoqeria si qiradhenes

Qirate ku shoqeria nuk transferon konsiderueshem risqet dhe perfitimet e pronesis te nje aktivi jane klasifikuar si qira operative. Kostot direkte fillestare, (ne se ndodhin)/te ndodhura per pershtatjen e ambjenteve sipas kerkeses se qiramarresit te nje qiraje operative i shtohen shumes se aktivitet te dhene me qira dhe njihen ne te njejten baze si te ardhura nga qiraja. Qirate e ndara do te njihen si te ardhura ne periudhe ne te cilen jane perfituar.

2.15.3. Depozitimet e qiramarresit

Detyrimet per depozitim te qiramarresit njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vazhdim me koston e amortizuar kur ka vlere materiale. Cdo diference midis vleres se drejte fillestare dhe vleres nominale perfshihet si nje e ardhur komponent te qirase operative dhe njihen ne menyre lineare pergjate gjithë termave te qirase.

2.16. Shpenzimet

Shpenzimet jane pakesime te perfitimeve ekonomike te cilat mund te shfaqen ne formen e daljes se mjeteve monetare, pakesimit te aktive ose shtimit te detyrimeve. Shpenzimet ndikojne ne uljen e vleres se kapitalit. Ato njihen ne baze te kontabilitetit rrites dhe paraqiten ne pasqyren e performances.

2.17. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv. Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet e aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

2.18. Kostot e huave

Kostot e huave te lidhura direkt me blerjen, ndertimin ose prodhimin e aktiveve, te cilat kerkojne nje kohe te gjate per t'u sjelle ne forme perfundimtare, ne menyre qe te perdoren apo shiten, i shtohen koston se ketyre aktiveve, deri ne momentin kur keto aktive jane gati per qellimin e tyre per perdorim. ose per shitje. Te ardhurat nga investimet e perkohshme, per sa i perket disa huave te vecanta, te cilave ende nuk iu eshte paguar interesi, kjo shume iu zbritet kostove te huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet koston se aktivitet. Te gjitha kostot e tjera njihen si te ardhura ose shpenzime ne periudhen kur ato kane ndodhur.

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.19. Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi, (e ardhura) tatimore, përmban shpenzimin tatimor aktual, (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë, (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet që lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e performances dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne ditën e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit të bilancit, duke marre si diference te perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkohshme do te zhduket.

Shoqeria mund te njohe aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë.

Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike mund të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë.

Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

2.20. Transaksionet me monedhat e huaja

2.20.1. Monedha e perdorur dhe raportuese

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdorim). Pasqyrat e financiare raportohen ne Leke (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Shoqerise.

2.20.2. Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e performances.

Gjate pergatitjes se pasqyrave financiare, transaksionet ne monedhe tjeter nga monedha funksionale, (monedha te huaja), regjistrohen me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Ne fund te cdo periudhe raportuese, mjetet monetare ne monedhe te huaj rivlersohen me kursin e dates se raportimit. Mjetet jo monetare qe mbahen me vlere te drejte regjistrohen ne monedhe te huaj dhe rivlersohen me kursin e dates kur percaktohet vlera e drejte. Mjetet jo monetare qe maten me kosto historike ne monedhe te huaj nuk rivlersohen.

Kurset e kembimit me date 31.12.2019 sipas kursit te Bankes se Shqiperise jane:

	31 Dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Euro	121.77	123.42
USD	108.64	107.82

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.21. Standardet dhe amendimet e reja ose te ndryshuara

Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 dhe 2019.

2.21.1. SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të ardhurave, duke zëvendësuar SNK 18 "Të ardhurat", "SNK 11 Kontratat e ndërtimit", dhe disa Interpretime të lidhura me të ardhurat. Standardi i ri krijon një model njohjeje me bazë kontrolli të ardhurave dhe jep udhëzime shtesë në shumë fusha që nuk mbulohen në mënyrë të detajuar nga SNRF-te

ekzistuese, duke përfshirë mënyrën për njohjen e marrëveshjeve me detyrime të shumta të performancës, çmime të ndryshueshme, të drejtat e rimbursimit të konsumatorit, opsionet e riblerjes, dhe kompleksitete të tjera të zakonshme.

Kontabilizimi i të ardhurave që rezultojnë nga kontratat me klientet bëhet duke përdorur një model me pesë hapa:

- Identifikimi i kontrates me një klient
- Identifikimi i detyrimeve të performancës në kontratë
- Përcaktimi i cmimit të transaksionit
- Shpërndarja e cmimit të transaksionit ndaj detyrimeve të performancës në kontratë, dhe
- Njohja e të ardhurave kur njësia ekonomike përmbush një detyrim të performancës

Sipas SNRF 15, parimi bazë është që një njësia ekonomike do të njohë të ardhurat në një shumë që reflekton shumën në të cilën njësia ekonomike pret të ketë të drejtën në këmzim të transferimit të shërbimeve për një klient.

Ndryshimet kryesore nga praktika aktuale:

- Cdo mall apo shërbim i premtuar, i cili është i dallueshëm, duhet të njihet me vete, dhe cdo zbritje mbi cmimin e kontrates, në përgjithësi duhet të shpërndahet mbi elementet e vecante.
- E ardhura mund të njihet me heret sesa sipas standarteve aktuale nëse vlerësimi ndryshon për ndonjë arsye (siç mund të jenë incentivat, ulje të tjera, tarifave të performancës, honoraret, suksesi i një rezultati etj.), shuma minimale duhet të njihet nëse ato nuk përbejnë një risk të rëndësishëm kthimi.
- Momenti në të cilën e ardhura është e mundur të njihet mund të zhvendoset: disa të ardhura të cilat aktualisht janë njohur në momentin e përfundimit të kontrates, mund të duhen të njihen gjatë kohezgjatjes së kontrates ose e kundërta.
- Ka rregulla specifike mbi licencat, garancite, tarifave fillestare të parimbursueshme dhe marrëveshjet e ndërmjetesimit, sa për të përmendur disa.

SNRF 15 hyri në fuqi në periudhat raportuese vjetore që filluan më ose pas 1 janar 2018.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është shitja e produktit të prodhuar, dhe ajo njihet në të ardhura korente vlerën e ndërtimit, (kostot e ndërtimit), dhe të ardhura nga shitja me dorezimin e produktit të klientit përfundimtar.

Per periudhën 2019, shoqëria ka bërë ndryshime në politikën kontabel, për kontabilizimet e prodhimit në proces, ndryshim gjendje prodhim proces, produktin e gatshëm, duke përdorur llogaritë: prodhim në proces, ndryshim gjendje prodhim në proces, produkt i gatshëm dhe ndryshim gjendje produkt i gatshëm.

Ndryshimet janë bërë referuar SNK 8, paragrafi 19, pika b dhe paragrafit 22 e 23,

"kur një ndryshim në politikën kontabel zbatohet në retrospektive në përputhje me paragrafin 19(a) ose (b), njësia ekonomike rregullon tepërcën e çeljes të secilit element të ndikuar të kapitaleve të veta për periudhën më të fundit paraardhëse të paraqitur dhe shumat e tjera krahasuese të deklaruara për secilën periudhë paraardhëse të dekluar sikur politika e re kontabel ka qenë zbatuar përgjithmonë"

Ndryshimet nuk kanë efekte në rezultatin e periudhës, për pasojë as efekte tatimore.

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.21 Standardet dhe amendimet e reja ose te ndryshuara (vazhdim)

2.21.2. SNRF 16 "Qiratë"

SNRF 16 ka zëvendësuar SNK 17 dhe tre Interpretimet përkatëse. Kjo kompletoi projektin e gjatë e BSNK-së për të rishikuar kontabilitetin e qirave. Qiratë do të regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar në formën e një të drejte përdorimi të një aktivi dhe të një detyrimi qiraje.

SNRF 16 hyri në fuqi në periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2019.

Për të përcaktuar ndikimin e IFRS 16, Shoqëria ka kryer proceduarit sa me poshte:

- një rishikimi të plotë të të gjitha marrëveshjeve për të vlerësuar nëse ndonjë kontratë shtesë tani do të bëhet një qira sipas përkufizimit të ri SNRF 16;
- përcaktimit të dispozitave kalimtare që do të miratojnë; aplikimin e plotë retrospektiv ose aplikimin e pjesshëm retrospektiv (që do të thotë informacioni krahasues nuk duhet të riparaqitet). Aplikimi i metodës së pjesshme jep gjithashtu një opsion lehtësimi për rivlerësimin nëse kontratat ekzistuese janë, ose përmbajnë, një qira, si edhe lehtësime të tjera. Përcaktimi se cilët nga këto praktika do të miratohen është i rëndësishëm pasi ato janë zgjedhje të pakthyeshme
- vlerësimin të informacioneve shpjeguese të saj aktuale për qiratë financiare dhe qirave operative pasi këto kanë të ngjarë të formojnë bazën e shumave që do të kapitalizohen dhe të bëhen të drejta përdorimi të asetëve
- përcaktimin se cilat thjeshtëzime opsionale kontabel do të zbatohen për portofolin e tyre të qirasë dhe nëse se do të përdoren përjashtime
- vlerësimin të sistemit të IT dhe nëse nevojitet një sistem të ri leasing. Kjo është duke u konsideruar në përputhje me zbatimin e SNRF 15 dhe SNRF 9 në mënyrë që Shoqëria vetëm t'i nënshtrohet një sërë ndryshimesh të sistemit njëkohësisht
- vlerësimin për dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë që do të nevojiten.

Shoqëria ka filluar aplikimin e SNRF 16 që prej 1 janar 2019 duke përdorur metodën e modifikuar të paraqitjes retrospektive të Standardit.

Sipas kësaj qasjeje, efekti kumulativ i zbatimit fillimisht të SNRF 16 njihet si një rregullim në kapital në datën e aplikimit fillestar. Informacioni krahasues nuk riparaqitet.

Zgjedhja e kësaj qasjeje të tranzicionit rezulton në vendime të mëtejshme të politikave që shoqëria duhet të bëjë pasi ka disa lehtësime të tjera kalimtare që mund të aplikohen.

Këto lidhen me ato qira të mbajtura më parë si qira të zakonshme dhe mund të aplikohen në bazë të analizimit të cdo kontratë.

Aplikimi i SNRF 16 nuk ka pasur efekte në rezultatin e periudhës, për pasojë as efekte tatimore.

2.21.3. SNRF 9 "Instrumentet Financiare"

Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF 9) paraqet ndryshime të mëdha në udhëzimet e SNK 39 mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe prezanton një model të ri "humbje krediti të pritshme" për zhvlerësimin e aktiveve financiare. SNRF 9 gjithashtu ofron udhëzime të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Gjatë adoptimit të SNRF 9, shoqëria ka aplikuar lehtësim në tranzicion dhe ka vendosur të mos ripërtërijë periudhat paraprake. Diferencat që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 në lidhje me klasifikimin, matjen dhe zhvlerësimin njihen në fitimet e pashpërndara.

SNRF 9 gjithashtu përmban kërkesa të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Kërkesat e reja kërkojnë të harmonizojnë më shumë kontabilitetin mbrojtës me aktivitetet e administrimit të rrezikut të njësive duke rritur mundësinë e depozitave të mbrojtura dhe instrumenteve mbrojtës dhe duke paraqitur një qasje më të bazuar në parime për të vlerësuar efektivitetin mbrojtës. Shoqëria zbaton kërkesat e reja të kontabilitetit mbrojtës në mënyrë prospektive dhe të gjitha mbrojtjet kualifikohen për t'u konsideruar si marrëdhënie mbrojtëse të vazhdueshme.

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.21 Standardet dhe amendimet e reja ose të ndryshuara (vazhdim)

2.21.3. SNRF 9 "Instrumentet Financiare" (vazhdim)

Miratimi i SNRF 9 ka ndikuar fushat e mëposhtme:

- Klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare të Shoqërisë. Drejtimi ka aktive financiare për të mbajtur dhe mbledhur flukset monetare. Obligacionet e klasifikuara më parë si investime të mbajtura në maturim (HTM) sipas SNK 39 vazhdojnë të kontabilizohen me koston e amortizuar (AC) pasi ato plotësojnë detyrimet e mbajtura për të mbledhur sipas modelit të biznesit dhe testin e karakteristikave të flukseve monetare kontraktuale në SNRF 9.
- Shoqëria ka zgjedhur që në mënyrë të pakthyeshme të përcaktojë investimet e reja në letrat me vlerë të klasifikuar më parë si të disponueshme për shitje (AFS), sipas SNK 39 tani me vlerën e drejtë me ndryshimet e paraqitura në të ardhurat e tjera përmbledhëse.
- zhvlerësimi i aktiveve financiare duke zbatuar modelin e pritur të humbjes së kredisë. Kjo ndikon në llogaritë e arkëtueshme tregtare të shoqërisë dhe investimet në aktivet e tipit të borxhit të matura me koston e amortizuar.

Në datën e aplikimit fillestar, më 1 janar 2018, dhe me pas, instrumentet financiare të shoqërisë për efektet e riklasifikimit analizohen si më poshtë.

Kategoria e Aktiveve Financiare	Klasifikimi SNK 39		Matja SNRF 9	Konkluzioni
Mjete monetare	HTM	AC	Priten të përmbushin kriteret e SPPI AC	Nuk ka impakt
Llogari/Kerkesa të arketueshme	HTM	AC	Priten të përmbushin kriteret e SPPI AC	Nuk ka impakt
Llogari/Kerkesa të tjera të arketueshme	HTM	AC	Priten të përmbushin kriteret e SPPI AC	Nuk ka impakt

Shoqëria ka vendosur të mos riparaqesë informacionin krahasues në zbatimin fillestar të SNRF 9. Zbatimi i SNRF 9 dhe ndryshimi i politikës kontabel për ndikimin e bilancit fillestar të Shoqërië më 1 janar 2019 paraqitet në tabelën në vijim. Në datën e aplikimit fillestar, më 1 janar 2018, instrumentet financiare të shoqërisë për efektet e matjes analizohen si më poshtë.

Aktivët	31 dhjetor 2018	Riparaqitje e balancave hapëse	1 janar 2019
Mjete monetare	14,900,947	-	14,900,947
Llogari/Kerkesa të arketueshme	20,415,185	-	20,415,185
Llogari/Kerkesa të tjera të arketueshme	70,590,600	-	70,590,600
Total	105,906,732	-	105,906,732

Shoqëria zbaton një model të thjeshtëzuar të njohjes së humbjeve të pritshme të kredise, llogaritë e arkëtueshme tregtare të shoqërisë, të tjera të arketushme, të matura me koston e amortizuar dhe vlereson se, nuk ka një ndikim të rëndësishëm financiar në datën e aplikimit fillestar të standardit.

➤ Përcaktimi i vlerës së drejtë

Disa politika kontabel dhe shënime shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet si financiare ashtu edhe jo-financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime matje dhe/apo shpjeguese bazuar në metodat e mëposhtme. Aty ku është e aplikueshme, informacion i mëtejshëm rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet përkatëse të atij aktivi apo detyrimi.

2. Politikat kryesore kontabel (vazhdim)

2.21 Standardet dhe amendimet e reja ose te ndryshuara (vazhdim)

2.21.3. SNRF 9 "Instrumentet Financiare" (vazhdim)

Aktivitetet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë për llogaritë e arkëtueshme është vlerësuar me vlerën aktuale të flukseve të ardhshme monetare, skontuar me normën e tregut të interesit në datën e raportimit. Kjo vlerë e drejtë është përcaktuar për qëllime shënimi shpjegues.

Detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë, e cila është përcaktuar për qëllime shënimi shpjegues, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të flukseve të ardhshme të principalit dhe interesit, skontuar me normën e tregut të interesit në datën e raportimit.

Vlera e drejtë për mjetet monetare dhe ekuivalente me to, llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme është afërsisht e barabartë me vlerën e tyre të mbartur për shkak të maturitetit të tyre afatshkurtër.

➤ Administrimi i riskut financiar

Shoqëria ekspozohet ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiarë:

- ✓ risku i kredisë
- ✓ risku i likuiditetit
- ✓ risku i tregut

Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimet e Shoqërisë ndaj secilit nga risqet e sipërpërmendur, objektivat, politikat dhe proceset që ajo përdor për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut. Shënime të tjera sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare. Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve.

Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve e procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në banka, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, huamarrje dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

Ndikimi në klientët

Debitorët e Shoqërisë mund të ndikohen nga situata e likuiditetit të ulët i cili mund të ndikojë aftësinë e tyre për ripagimin e shumave që detyrohen. Përkeqësimet e kushteve shfrytëzuese për klientët mund të ndikojnë gjithashtu parashikimet e fluseve monetare nga drejtimi dhe vlerësimin e zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe jo-financiare. Deri në atë masë që informacioni është i disponueshëm, drejtimi ka reflektuar siç duhet vlerësime të korrigjuara të flukseve monetare të pritshme në vlerësimet e zhvlerësimit.

(i) Rreziku kreditor

Ekziston një rrezik kredie në momentin që palët nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre lidhur me pagesat e llogarive të arkëtueshme.

Maksimumi i rrezikut të kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme minus detyrimet kundrejt të njëjtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Rreziku i kredisë i cili është identifikuar merret parasysh nëpërmjet zhvlerësimeve. Shoqëria e vlerëson cilësinë e llogarive të arkëtueshme që nuk janë me vonesë dhe as të zhvlerësuara si të kënaqshme.

KONTAKT sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në Lek, përveç se kur është shprehur ndryshe)

➤ Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor

Vlera e mbartur e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal ndaj riskut të kredisë. Ekspozimin maksimal ndaj riskut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	Shenimi	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme	4a	37,893,824	20,415,185
Të drejta ndaj palëve të lidhura		46,191,229	46,191,229
Paraja dhe ekuivalentet e saj	6	48,951,953	14,900,947

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të çdo klienti. Nuk ka një përqendrim të rëndësishëm të rrezikut të kredisë.

Lëvizja në humbjen kumulative nga zhvlerësimi në llogaritë e arkëtueshme gjatë vitit është si më poshtë

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Më 1 janar	-	-
Humbja e njohur nga zhvlerësimi	-	-
Më 31 dhjetor 2019	-	-

Humbja nga zhvlerësimi

Vjetërsia e arkëtueshme në datën e raportimit është:

	Shuma bruto 2019	Zhvlerësimi 2019	Shuma bruto 2018	Zhvlerësimi 2018
Të vjetra më pak se 1 vit	33,547,242	-	16,910,946	-
Të vjetra më shumë se 1 vit	4,346,584	-	3,504,239	-
Zhvlerësimi				
Gjëndja në fund të vitit	37,893,824	-	20,415,185	-

Drejtimi gjykon se do të arkëtojë 100% të llogarive të arkëtueshme.

(ii) *Risku i likuiditetit*

Shoqëria duhet të përmbushë nevojat për mjete monetare, kryesisht për kostot e shfrytëzimit që rrjedhin nga aktiviteti i saj. Ekziston rreziku që mjetet monetare mund të mos jenë të disponueshme për të shlyer detyrimet në kohën e duhur me një kosto të arsyeshme. Shoqëria monitoron likuiditetin e saj periodikisht në mënyrë që të administrojë detyrimet e saj kur nevojitet. Shoqëria administron rrezikun kryesisht përmes mbështetjes së financimit afatshkurtër dhe afatgjatë prej bankave dhe palëve të lidhura.

Ekspozimi ndaj riskut të likuiditetit

Më poshtë janë paraqitur maturitetet kontraktuale të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve financiare në 31 dhjetor 2019 dhe 2018:

KONTAKT sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në Lek, përveç se kur është shprehur ndryshe)

➤ Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(ii) Risku i likuiditetit (vazhdim)

	31 dhjetor 2019				Totali
	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	
Llogari të arkëtueshme	29,088,620	8,805,205			37,893,825
Të drejta ndaj palëve të lidhura				46,191,229	46,191,229
Të arkëtueshme të tjera		5,729,192		19,728,010	25,457,202
Paraja dhe ekuivalentet e saj	48,951,953				48,951,953
	78,040,573	14,534,397	-	65,919,239	158,494,209
Huamarrje			50,220,262	520,134,513	570,354,775
Detyrime ndaj palëve të lidhura				340,367,195	340,367,195
Llogari të pagueshme		107,769,562	46,186,955		153,956,517.4
Detyrime të tjera			809,573,151	379,904,594	1,189,477,745
	-	107,769,562	905,980,368	1,240,406,302	2,254,156,232
Ekspozimi neto	78,040,573	- 93,235,165	-905,980,368	-1,174,487,062	- 2,095,662,023
Kumulative	78,040,573	- 15,194,593	-921,174,961	-2,095,662,023	

(iii) Risku i tregut

Risku i normës së interesit

Shoqëria përballet me ndikimin e flukseve të parasë nga norma e interesit lidhur me huatë që ka marrë. Manaxhimi i Shoqërisë nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje për instrumenta derivativë me qëllim mbrojtjen nga ky risk.

Ekspozimi ndaj riskut të normës interesit

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, të gjitha instrumentat financiarë që mbartin interes kishin normë interesi të ndryshueshme.

Një ndryshim me 100 pikë në normën e interesit më 31 dhjetor 2019 do të sillte rritje ose ulje në kapital dhe rezultat në shumën zero Lek (2018: 0).

Risku i kurseve të këmbimit

Shoqëria kryen transaksione kryesisht në Lekë, Euro dhe USD. Risku i monedhës kryesisht manaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së të drejtave dhe detyrimeve. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për kontrata të ardhshme shkëmbimi më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

Ekspozimi ndaj riskut të kursit të këmbimit

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të kursit të këmbimit në 31 dhjetor 2019 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2019				
	EURO	USD	GBP	LEK	TOTAL
Llogari të arkëtueshme	119,705	-	-	23,317,312	37,893,825
Të drejta ndaj palëve të lidhura	-	-	-	46,207,774	46,207,774
Të arkëtueshme të tjera	152,920			6,819,575	25,440,657
Paraja dhe ekuivalentet e saj	1,044,151			7,044,676	134,190,953
	1,316,776	-	-	83,389,337	243,733,209
Huamarrje	4668718.11			1,844,971	570,354,775
Detyrime ndaj palëve të lidhura	1895207.65			109,587,759	340,367,195
Llogari të pagueshme	1,139,200			15,236,101	153,956,517
Detyrime të tjera	9,768,233			-	1,189,477,745
	17,471,359	-	-	126,668,831	2,254,156,232
Ekspozimi neto më 31 dhjetor 2019	- 16,154,583	-	-	43,279,493	- 2,010,423,023

➤ Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(iii) Menaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatore.

2.22. Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, si dhe ndryshime të standardeve ekzistuese, që ende nuk janë efektive dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria, janë publikuar nga BSNK. Informacion mbi ato standarde që pritet të jenë të rëndësishme për pasqyrat financiare të Shoqërisë është dhënë më poshtë. Drejtimi pret që të gjitha standardet relevante do të miratohen në politikat kontabël të Shoqërisë për periudhën e parë që fillon pas hyrjes në fuqi të shpalljes. Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet të cilat nuk janë miratuar apo të shënuara më poshtë nuk pritet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Standardet e mëposhtme të ndryshuara nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në Pasqyrat Financiare të shoqërise:

- Ndryshimet në Referencat e *Kuadrit Konceptuale në Standardet e SNRF-ve*.
- SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet dhe Gabimet e Kontabilitetit (Ndryshimi - Përkufizimi i Materialit)
- Përkufizimi i biznesit (Ndryshimet në SNRF 3).
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve.

KONTAKT sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Të gjitha shumatat në Lek, përveç se kur është shprehur ndryshe)

3. a Aktivet Afatgjata Materiale

Gjate periudhes ushtrimorete mbyllur me 31 Dhjetor, sipas Bilancit Kontabel, te paraqitur jane bere kontabilizimet per blerje te Aktivet Afatgjata Materiale. Keshthu qe Vlera neto e aktiveve te Afatgjata Materiale paraqitet sa me poshte:

	Toka	Ndertesa	Makineri Pajisje	Mjete transporti	IT+Mob Zyre	Totali
Aktive te Trupezuara						
Gjendje 01.01.2019	-	202,816,853	75,195,502	64,036,458	51,508,960	393,557,773
Shtesa	-	-	19,677,933	2,999,128	6,998,963	29,676,024
Pakesime	-	(3,036,471)	(875,180)	(1,320,406)	(89,080)	(5,321,137)
Levizje brenda grupeve			1,437,878		(1,437,878)	
Gjendje 31.12.2019	-	199,780,382	95,436,133	65,715,180	56,980,965	417,912,660
Amortizimi						
Gjendje 01.01.2019	-	51,248,796	23,828,160	16,564,957	22,707,988	114,349,901
Shtesa llogaritur	-	7,499,708	11,819,123	9,546,620	6,048,876	34,914,327
Pakesime	-	(354,382)	(75,577)	(661,228)	(66,276)	(1,157,463)
Gjendje 31.12.2019	-	58,394,122	35,571,706	25,450,349	28,690,588	148,106,765
Vlera neto 01.01.2019	-	151,568,057	51,367,342	47,471,501	28,800,972	279,207,872
Vlera neto 31.12.2019	-	141,386,260	59,864,427	40,264,831	28,290,377	269,805,895

3. b Pasqyra e ndryshimit të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale:

	Certifikata ISO	Softuer	Totali
Gjendje 01.01.2019	801,706	132,950	934,656
Shtesa	-	-	-
Pakesime	6,739	-	6,739
Gjendje 31.12.2019	<u>794,967</u>	<u>132,950</u>	<u>927,917</u>
<i>Amortizimi</i>			
Gjendje ne 01.01.2019	530,619	19,943	550,562
Shtesa llogaritur	54,217	22,601	76,818
Pakesime	-	-	-
Gjendje 31.12.2019	<u>584,836</u>	<u>42,544</u>	<u>627,380</u>
Vlera neto 01.01.2019	<u>271,087</u>	<u>113,007</u>	<u>384,094</u>
Vlera neto 31.12.2019	<u>210,131</u>	<u>90,406</u>	<u>300,537</u>

Shoqëria nuk ka shtuar aktivet afatgjata jo materiale në pronësi të saj për priudhën, me blerje të cilat mund të ishin paraqitur, vlerësuar dhe kontabilizuar drejt, konform rregullave të vendosura.

Amortizimi

Amortizimi i Aktiveve të Qendrueshme të Trupezuara për vitin 2019 është llogaritur sipas normave fiskale të amortizimit, i cili në gjykim të drejtimit, përputhet me SNK.

4. Aktive të tjera financiare afatshkurter

Aktive të tjera financiare afatshkurter me datë 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kerkesa të arketueshme	37,893,824	20,415,185
Llogari/Kerkesa të tjera të arketueshme	71,648,431	70,590,600
Aktive Financiare Afatshkurtra	85,239,000	-
Totali	<u>194,781,255</u>	<u>91,005,785</u>

Në politikat kontabel për zbatimin IFRS 15, për vitin 2019, janë bërë ndryshime në paraqitjen e gjendjeve të vitit 2018, për efekte të krahasueshmërisë, referuar IFRS për Rregullimet Kontabel. Është përdorur llogaria inventariale prodhim në proces, ku ka kaluar shuma e mbajtur në detyrime afatshkurtra, kerkesa të arketueshme.

KONTAKT sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në Lek, përveç se kur është shprehur ndryshe)

4. a - Kërkesa për t'u arketuar

Kërkesat për t'u arketuar nga Kliente, në datë 31 dhjetor paraqiten në bilanc me vlerën e tyre të drejtë. Në mënyrë analitike paraqiten:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kliente punime të ndryshme	35,595,602	17,775,680
Kliente për qira	2,272,092	2,538,860
Kliente administrimi	26,130	100,644
Totali	37,893,824	20,415,184

4. b - Kërkesa të tjera të arketueshme

Kërkesat e tjera të arketueshme me datë 31 dhjetor paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
TVSH	5,291,244	15,017,553
Detyrime doganore	82,370	124,780
Tatim Fitimi	339,032	428,565
Garanci të dhena	1,457,827	1,002,060
Te tjera debitoare	46,212,458	34,565,642
Hua në të tretë	18,265,500	19,452,000
Totali	71,648,431	70,590,600

5. Inventari

Gjendja e inventareve në datë 31 Dhjetor paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Lende e pare	20,184,006	8,452,549
Prodhim Proces	1,208,958,136	1,128,781,619
Produkt i gatshëm	158,988,296	-
Shpenzime për t'u shperndare	1,222,972,968	1,420,549,313
Parapagim për furnizime	17,041,920	37,245,173
Totali	2,628,145,326	2,595,028,654

Gjendja e materialeve dhe mallrave të blera paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e marrjes (kosto e blerjes).

Shënim: Shpenzime të periudhave të ardhshme janë përfshirë në tabelën mesipërme me emërtimin "shpenzime për t'u shperndare".

Në zerin nr 5, Inventar, paraqiten gjendje prodhim në proces, që janë objekte në ndërtim/zhvillim, regjistruar sipas kontabilitetit rrites: vlerë situacioni plus pjesën takuese të taksave dhe projekteve të parapaguara për to, sipas % së zhvillimit, (vlerë e situacionit mujor pjestuar me preventivin).

Produkt i gatshëm: njësi të hipotekuara dhe që janë në proces shitje;

Shpenzime të parapaguara për projekte dhe taksa, për objektet në zhvillim, (shpenzime për tu shperndare).

KONTAKT sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në Lek, përveç se kur është shprehur ndryshe)

6. Mjete Monetare

Mjetet Monetare (Likuiditetet) janë paraqitur në bilanc me gjendjen e llogarive bankare në fund të periudhës me datë 31 dhjetor të cilat janë të njëjta me ekstratin e fundit të bankave për këtë periudhë si dhe me gjendjen e Parave në arken e Shoqërisë.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Union Bank ALL	7,042,652	1,779,125
Intesa sanpaolo Bank ALL	2,024	23,550
Union Bank EUR	35,343,996	11,410,211
Intesa sanpaolo Bank EUR	6,563,281	1,688,061
Totali	48,951,953	14,900,947

7. Kapitali

Kapitali themeltar, Rezerva, Fitim e Humbje me datë 31 dhjetor paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kapitali i nënshkruar	659,221,542	659,221,542
Rezerva ligjore	1,253,178	1,253,178
Rezerva të tjera	-	-
Fitim i pashperndar	159,174,214	-
Fitime/Humbje të vitit financiar	68,179,800	159,174,214
Totali	887,828,734	819,648,934

8. Pasivet Afatgjata

Pasivet Afatgjata me 31 Dhjetor paraqiten në vlerë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kredi	519,628,924	441,742,905
Grande dhe të ardhura të shtyra	505,589	19,664,635
Totali	520,134,513	461,407,540

Kredia detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Ekuivalent në leke	403,255,609	370,260,000
Kesti afatshkurter i kredise afatgjate	-	(29,111,633)
Kredi Individuale	116,373,315	100,594,538
Totali	519,628,924	441,742,905

9. Huate dhe parapagimet

Huate dhe Parapagimet me date 31 dhjetor paraqiten si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua bankare	50,220,262	29,111,632
Te pagueshme ndaj furnitoreve	139,730,600	47,829,813
Te pagueshme ndaj punonjesve	749,710	11,122,973
Detyrime tatimore	5,706,918	2,017,515
Te tjera detyrime	348,136,484	438,450,365
Garanci te dhena	-	187,590
Parapagime te arketuara	1,189,477,744	1,170,750,990
Totali	<u>1,734,021,718</u>	<u>1,699,470,878</u>

9.a - Te pagueshme ndaj furnitoreve

Detyrimet ndaj furnitoreve jane paraqitur ne bilanc per shumat qe do te paguhen pas dates 31 dhjetor ne total jane 139,730,160 leke te detajuara ne tabelen bashkangjitur ketij materiali:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitore te vitit	139,730,600	47,829,813
Furnitore mbi nje vit	-	-
Totali	<u>139,730,600</u>	<u>47,829,813</u>

9.b - Detyrimet tatimore

Ne pasiv te bilancit gjendja e detyrimeve te shoqerise kundrejt shtetit paraqitet si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tatim page	2,683,002	447,669
Sigurime shoqerore	2,586,279	1,569,846
Tatim fitimi	-	-
Tatim ne burim	437,637	-
Totali	<u>5,706,918</u>	<u>2,017,515</u>

Ne llogaritjen e detyrimeve shoqeria ka mbajtur parasysh kerkesat e Legjislacionit fiskal ne Republiken e Shqiperise, duke pasqyruar TVSH, tatimin mbi fitimin, tatimin mbi te ardhurat personale si dhe ate ne burim te llogaritur, te regjistruar drejt dhe te papaguar per detyrimin e krijuar ne muajin dhjetor 2019.

KONTAKT sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në Lek, përveç se kur është shprehur ndryshe)

10. Shitjet neto

Shoqëria për vitin 2019 ka realizuar shitje si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shitje njesi banimi e sherbimi	1,141,901,279	519,230,516
Ndryshim gjendje prod gatshem	(968,077,382)	(240,488,365)
Ndryshim gjendje prodhim proces	1,017,550,558	180,468,647
Shitje punime ndertimi ne te trete	77,350,966	331,304,166
Shitje sherbime te ndryshme	30,957,922	79,852,300
Te ardhura AAM te shitura	4,603,754	5,967,245
Qira	27,669,913	35,608,996
Shitje materiale ndertimi	3,317,263	-
Totali	<u>1,335,274,273</u>	<u>911,943,505</u>

11. Mallra lende te para, mallra dhe sherbime

Ne kete ze perfshihen shpenzimet per blerje e mallrave si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime lende te para & mallra	295,789,291	152,384,544
Punime nga nenkontraktore	367,178,341	528,059,860
Totali	<u>662,967,632</u>	<u>680,444,404</u>

KONTAKT sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në Lek, përveç se kur është shprehur ndryshe)

12. Shpenzime të tjera nga veprimtari e shfrytëzimit

Ne këtu ze përfshihen shpenzimet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Taksa e ndikimit infrastrukture	183,393,290	-
Shpenzime për projekte	126,104,725	200,000
Sponsorizime	69,216,087	2,529,548
Marketing	24,999,941	17,382,091
Interesa kredie	20,067,988	-
Administrative	19,199,604	19,175,917
Mirembajtje	16,804,726	20,478,420
Karburant	13,470,398	11,720,481
Tarife aplikimi leje ndertimi	10,900,538	-
Udhetime e dieta	9,171,887	15,948,097
Gjoha dhe demshperblime	7,999,281	1,012,739
Taksa dhe tarifa vendore	7,926,927	4,662,901
Ushqim personeli	7,845,901	-
Shpenzime energjie dhe uje	6,486,083	3,524,392
Noteriale-financiare	6,063,821	1,510,322
Materiale kantieri	4,079,696	-
Vlera kontabel e aktiveve të shitura	4,072,805	4,376,524
Pritje, perfaqesime, dreka, darka, uje, kafe	2,479,505	12,504,154
Shpenzime trajnim personeli	2,326,815	-
Shpenzime vleresimi e aplikime, police sigurimi	1,441,196	63,370
Qira dhe roje	1,036,496	1,261,574
Kancelari	1,020,168	1,028,001
Shpenzime telefon	784,624	771,425
Sherbime bankare	728,932	690,464
Donacione dhe dhurime	417,665	-
Kujdesi shendetesor (mjek)	300,000	-
Transporte për blerje	290,315	187,595
Te tjera për personelin	55,994	-
	548,685,408	119,028,015

Shërbime financiare për vitin më 31 dhjetor 2019 përfshijnë tariafat e auditimit në vlerë 572,319 Lek (2018: 570,000 Lek)

13. Shpenzime te personelit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet e pages dhe sigurimet shoqerore si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paga dhe shperblime	142,562,218	83,737,788
Shpenzime per trajnime kualifikime personeli	-	162,136
Kujdesi Shendetsor	-	1,158,212
Ushqim personeli	-	179,303
Sigurime shoqerore	15,572,712	12,674,519
Totali	<u>158,134,930</u>	<u>97,911,958</u>

Me 31 dhjetor 2019 shoqeria kishte 130 punonjes (2018: 107) ndersa numri mesatar i punonjesve per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 ishte 115 (2018: 111).

Pagat dhe kontributet per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2019 dhe ate qe mbyllet me 31 dhjetor 2018 detajohen si me poshte:

	Nr. mesatar	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Keshilli Drejtues	-	-	-
Menaxhimi	2	5,990,663	5,396,980
Personeli, Administrata	61	106,171,819	45,783,178
Personeli, Punetore	52	45,972,448	45,232,149
Totali	115	<u>158,134,930</u>	<u>96,412,307</u>

14. Shpenzime Financiare

Ne kete ze perfshihen te ardhurat dhe shpenzimet financiare te paraqitura si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Fitim nga kembime valutore	175,629,562	3,704,532
Te ardhura nga interesat	-	-
Te ardhura te tjera	-	-
Shpenzim nga kembime valutore	(11,226,915)	(7,210,646)
Shpenzime te tjera financiare	4,684	-
Totali	<u>164,407,331</u>	<u>(3,506,114)</u>

15. Fitimi (Humbje) Neto

Fitimi neto i vitit financiar te mbyllur eshte llogaritur si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Fitim Bruto	94,902,487	187,442,500
Shpenzime te pa njohura	83,248,760	1,012,739
Baza llogaritjes Tatimit	178,151,247	188,455,239
% e Tatim Fitimit	15%	15%
Tatim Fitimi	<u>26,722,687</u>	<u>28,268,285.81</u>
Fitimi NETO	<u>68,179,800</u>	<u>159,174,214</u>

KONTAKT sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në Lek, përveç se kur është shprehur ndryshe)

16. Te ardhurat dhe FDP

Te ardhurat perputhen me FDP te dekalruara per cdo muaj.

17. Vijimësia

Drejtimi deklaron se nuk ka probleme te vijimësine

18. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Homeplan - klient	456,635	-	-	-
Homeplan - kreditor	-	284,392,126	-	365,775,040
Homeplan - debitor	46,191,229	-	46,039,824	-
F. Bektashi - kreditor	-	116,373,315	-	97,326,152
	46,647,864	400,765,441	46,039,824	463,101,192

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018	
	Të ardhura	Shpenzime	Të ardhura	Shpenzime
Fatmir Bektashi - paga	-	1,752,077	-	1,722,502
	-	1,752,077	-	1,722,502

19. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Me 31 dhjetor 2019 Shoqëria ka disa çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj, por Drejtimi i Shoqërisë nuk mendon se do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

20. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.